

**PRONONCIM**

Prononcim i kryebashkiakut Mziu: Problematikat e arsimit në Kamëz dhe mungesa e vëmendjes nga qeveria



FAQE 4

**INVESTIME**

Vijojnë punimet në rrugën "Pjetër Arbënor" në lagjen 1 Bathore



FAQE 3

**UJËSJELLËS-KANALIZIMET**

Kryebashkiaku Mziu, takim me z. Helmfried Dietsch për zbatimin sa më të shpejtë të projektit



FAQE 8

**SOCIALE**

Reprezalja "Rama" në 4 muaj/ 25 mijë familje u hoqën nga ndihma ekonomike, 6 mijë në Kamëz!



FAQE 6



Gazetë e Bashkisë Kamëz

# KAMËZA

E përdyjavshme  
Nr. 217 shtator 2018  
Çmimi 20 lekë  
drmediakamez@gmail.com  
www.kamza.gov.al

## KRYEBASHKIAKU MZIU INSPEKTON PUNIMET NË INVESTIMET E BASHKISË

FAQE 2-3

**Bashkia Kamëz gati të nisë punimet për rrugën "Mustafa Lita", 2.5 km e gjatë, përreth liqenit të Paskuqanit**

Faqe 2

**Kryebashkiaku Mziu: Pseudoreforma territoriale, konvikti në Kamëz menaxhohet nga Bashkia Tiranë**

Faqe 4

**Performancë financiare efiçente e Bashkisë Kamëz, kryebashkiaku Xhelal Mziu e ka vënë buxhetin në shërbim të qytetarëve**

Faqe 7

**Informatizimi i njësuar, një hap suksesi në rritjen cilësore të shërbimeve**

Faqe 8



**Bashkia Kamëz, përgatitje e infrastrukturës në të gjitha shkollat dhe kopshtet e qytetit për fillimin e vitit të ri arsimor**

FAQE 5



### NË BRENDËSI

Vëmendje maksimale e kryebashkiakut Xhelal Mziu për ndërtimin e një infrastrukture urbane bashkëkohore në gjithë qytetin

FAQE 3

Bashkia Kamëz riaplikon në raundin e dytë si lider në projektin BE EU CITIZENS: Building Europe through CIVIC participation

FAQE 7

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Bashkia Kamëz vazhdon intensivisht punën për verifikimin në terren të abonentëve

FAQE 8

Dështimi i radhës i Edi Ramës - Reforma e financave publike

FAQE 7

Në gjithë këto vite të qeverisjes së majtë, në Kamëz asnjë investim i vetëm nga qeveria

FAQE 6



## Kryebashkiaku Xhelal Mziu inspektion punimet te pedonalja dhe qendra e qytetit

Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka inspektuar punimet te pedonalja dhe qendra e qytetit, me përfundimin e të cilave së shpejti Kamza do të ketë një pamje të re. Bashkia ka nisur prej pak kohësh punimet të cilat vijojnë me intensitet për ndërtimin e sheshit të ri të qytetit Kamëz si dhe të pedonale. E gjendur e braktisur pas kërkesave bërë qeverisë për financim projektsh, Bashkia Kamëz dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu morën përsipër të financin vetë këtë projekt, një investim i konsiderueshëm për buxhetin vendor dhe me një impakt të madh për qytetarët. Qeveria e "Rilindjes" dhe Edi Rama nuk ka financuar asnjë projekt të Bashkisë, duke i diskriminuar politikisht banorët e Kamzës. Bashkia ka pasur si prioritet të saj përmirësimin e infrastrukturës dhe këtë e ka treguar me qindra kilometra rrugë të asfaltuara ndër vite. Në vitin 2017 kanë qenë 60 projekte në infrastrukturë që janë realizuar në Kamëz dhe Paskuqan, përfshirë këtu edhe rrugën "Demokracia" prej 7 km nga ura e Institutit deri në Babrru, e cila tashmë ka përfunduar, ndërsa gjatë këtij viti janë në proces realizimi mbi 80 projekte në infrastrukturë.

Punimet tek pedonalja e qytetit të Kamzës dhe qendra e re e qytetit vijojnë me intensitet të lartë. Pedonalja ka sipërfaqe 4936 metra katrorë, një shëtitore për mbarë



qytetarët e Kamzës që shtrihet nga qendra e qytetit deri në kryqëzimin me rrugën "Londra". Pedonalja, e cila po i jep një panoramë krejt ndryshe qytetit të Kamzës, do të sjellë përpara qytetarëve vizionin e Bashkisë jo vetëm thjesht për të ndryshuar pamjen, por ndryshimin e duhur në infrastrukturë, nëpërmjet këtij projekti me të gjithë parametrat e nevojshëm dhe bashkëkohorë. Si çdo projekt tjetër në Bashkinë Kamëz edhe ky investim madhor realizohet tërësisht me fondet e



Bashkisë. Ndërtimi i sheshit të ri në qendër të qytetit, pranë Pallatit të Kulturës, me sipërfaqe 3936 metra katrorë, është një nga investimet e shumta që janë pjesë e financimeve të buxhetit të Bashkisë. Zbatimi i këtij projekti përbën fazën e parë të ndryshimit të pamjes së qytetit, e cila promovohet në një kohë kur Bashkia është në një fazë të zbatimit të shumë projekteve që kanë lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës së qytetarëve të Kamzës.

### Vijon lirimi i hapësirave për ndërtimin e rrugëve "Veli Dedi" dhe "Xhorxhi Martini" në Fushë-Kërçik

Gjatë kësaj periudhe ka vijuar lirimi i hapësirave për realizimin e dhjetëra projekteve të reja të Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Një prej tyre është edhe ndërtimi i rrugëve "Veli Dedi" dhe "Xhorxhi Martini" në Fushë-Kërçik, ku po lirohen hapësirat për realizimin e këtij investimi të rëndësishëm për banorët e zonës. Kështu, pas përfundimit të prokurimit për ndërtimin e rrugëve "Veli Dedi" dhe "Xhorxhi Martini" në Fushë-Kërçik, së shpejti nisin punimet. Siç edhe kemi thënë më parë, viti



2018 për Bashkinë Kamëz shënon vijimësinë e investimeve themelore e të rëndësishme. Të parashikuara nga buxheti i Bashkisë,

këto investime përmirësojnë kryesisht infrastrukturën rrugore, të kanalizimeve, të arsimit etj. Përveç kësaj, e rëndësishme është se këto investime prekin çdo lagje të qytetit, duke përmirësuar ndjeshëm gjendjen e rrugëve, kanalizimeve, të objekteve të sistemit arsimor si kopshte dhe shkolla. Midis zonave ku Bashkia ka investuar dhe do të investojë edhe në të ardhmen është lagja Fushë-Kërçik, ku do të zbatohet projekti i ndërtimit të rrugës "Veli Dedi" dhe "Xhorxhi Martini",

me gjatësi 828 metra dhe gjerësi 7 metra. Ky projekt bën pjesë në strategjinë e zhvillimeve infrastrukturore në Bashkinë Kamëz. Me një gjatësi të konsiderueshme, ky investim bën të mundur lidhjen e mijëra familjeve të zonës me rrugën kryesore të Paskuqanit, bulevardi "Demokracia", duke qenë kështu pjesë e një rrjeti të rëndësishëm rrugor. Projekti financohet me të ardhurat e Bashkisë, meqenëse qeveria për pesë vite diskriminon qytetarët e Kamzës, duke mos akorduar asnjë financim për ta.

### Bashkia Kamëz gati të nisë punimet për rrugën "Mustafa Lita", 2.5 km e gjatë, përreth liqenit të Paskuqanit

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore është prioritet i Bashkisë Kamëz. Gjatë vitit 2018 janë në proces realizimi mbi 80 projekte në infrastrukturë (mbi 20 në Paskuqan), të cilat janë prokuruar, lidhur kontratat me firmat fituese, në disa prej këtyre investimeve vazhdon puna me intensitet dhe në një pjesë të tyre punimet do të nisin në ditët në vijim. Jo vetëm gjatë këtij viti, por edhe vitin e kaluar si dhe vitet paraardhëse, Bashkia Kamëz nën drejtimin e suksesshëm të kryebashkiakut Xhelal Mziu ka pasur prioritet absolut përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe prej vitit 2015 i njëjti prioritet, për të mos thënë dhe më i madh, ka qenë në Paskuqan ku në vitin 2017 pjesa më e madhe e



buxhetit shkoi për Njësinë Administrative të Paskuqanit.

Krahas 20 investimeve që po kryhen këtë vit në Paskuqan, një prej tyre mjaft i rëndësishëm dhe i konsiderueshëm është edhe rruga "Mustafa Lita" që përshkon gjithë liqenin e

Paskuqanit.

Impakti i investimit në rrugën "Mustafa Lita" do të jetë i jashtëzakonshëm për banorët e zonës. Kjo, për shkak se lidh në mënyrë organike lagjet e Njësisë Administrative Paskuqan me lagjen Bulçesh dhe duke rivitalizuar gjithë zonën që përfshin ky investim. Ndërtimi i rrugës "Mustafa Lita" është një nga projektet më të rëndësishme të Bashkisë Kamëz për vitin 2018, një investim prej të cilit përfitojnë më shumë se 2500 familje që banojnë përgjatë gjithë segmentit, një shifër kjo që tregon vëmendjen që institucioni i Bashkisë i kryen shërbimet dhe investimet me një studim mjaft të qartë urban. Deri më tani kjo rrugë ka qenë jashtë

kushteve të lëvizjes e komunikimit, qoftë për mjetet ashtu edhe për qytetarët e kësaj zone. Projekti i kësaj rruge kap gjatësinë prej 2420 metrash linearë dhe një gjerësi prej 8 metrash, duke përfshirë të gjithë parametrat e një rruge me standarde bashkëkohore.

Sigurisht që investimi do të krijojë mjaft lehtësi dhe përfitime, qoftë për ushtrimin e aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale, por krijohet një mundësi e re për çeljen e bizneseve të reja duke pasur njëkohësisht edhe ndikim të drejtpërdrejtë në çeljen e vendeve të reja të punës. Projekti do të financohet nga të ardhurat e Bashkisë Kamëz, të cilat kanë ardhur nga vitit në vit në rritje falë mirëmenaxhimit të tyre.

### Pas përfundimit të prokurimit nis së shpejti ndërtimi i rrugës "Ali Këlcyra" në Paskuqan 2 Vresht



Pas përfundimit të prokurimit nisin së shpejti punimet për ndërtimin e rrugës "Ali Këlcyra" në Paskuqan 2 Vresht, ashtu si dhjetëra investime të tjera të Bashkisë Kamëz për vitin 2018.

Ndërtimi i rrugës "Ali Këlcyra", 1 km e gjatë, është një nga investimet e rëndësishme

të Bashkisë të planifikuara në buxhetin e vitit 2018. Përveç gjatësisë së saj, që shkon më shumë sesa 1 km dhe me gjerësi 9 metra, realizimi i këtij projekti sjell një impakt të jashtëzakonshëm social, si për banorët e zonës, ashtu edhe për ata që zgjedhin të kalojnë në këtë segment rrugor. Si ky projekt janë me dhjetëra të tjera, në të gjitha lagjet e qytetit, ku do të nisin shumë shpejt punimet, pas procedurave të prokurimit. Bashkia Kamëz do të ndërhyjë me anë të këtij investimi për të krijuar kushte më të mira jetese për qytetarët e zonës, të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre për ndërtimin e infrastrukturës.

### Investime të rëndësishme të Bashkisë Kamëz në gjithë territorin, siç është edhe ndërtimi i rrugës "Bajram Curri" në Bathore



Investime të rëndësishme të Bashkisë Kamëz janë shpërndarë në gjithë territorin e qytetit, siç është edhe ndërtimi i rrugës "Bajram Curri" në lagjen 3 Bathore, e gjatë 333 metra linearë, ku së shpejti pritet të fillojnë punimet. Ky investim, i cili do të financohet tërësisht nga buxheti i Bashkisë Kamëz do të jetë me një gjerësi asfaltimi me 6 m duke përfshirë dhe dy kunetë në skajet anësore

që do të shërbejnë për mbledhjen e ujërave sipërfaqësore. Ky segment rrugor është pjesë e shtuar e inventarit të rrugëve që ka Bashkia Kamëz në rehabilitimin total të saj, duke e shndërruar këtë infrastrukturë me standarde bashkëkohore në ndikimin mjedisor. Rruga "Bajram Curri" shërben si nyje lidhëse për të gjitha segmentet rrugore përreth saj. Ky ndikim infrastrukturor në investim do të lehtësojë ndjeshëm komunikimin dhe lëvizjen e lirë të mjeteve si dhe qytetarëve. Investimi në infrastrukturën rrugore do të shërbejë për të nxitur qytetarët të hapin biznese të reja dhe ushtrimin e aktiviteteve tregtare. Si rrjedhojë ky impakt do të sjellë rritjen e numrit të punësuarve në veprimtari private dhe përmirësimin e ndjeshëm të jetesës në qytet.

## Shtresa e tapetit te rruga "Abdi Bej Toptani", kryebashkiaku Xhelal Mziu në terren për të inspektuar punimet

Shtator 2018

GAZETA KAMZA

3



Kryebashkiaku Xhelal Mziu ishte në terren gjatë punimeve për shtresën e fundit (tapeti) të rruga "Abdi Bej Toptani" në Valias, 1400 metra e gjatë, me gjerësi 10 ml, me kunetë 0.5 ml dhe trotuare në të dyja anët e rrugës me nga 2 ml gjerësi, investim me fondet e Bashkisë me parametra bashkëkohore, ndriçim e gjelbërim.



Rruga "Abdi Bej Toptani" po kthehet në një segment me parametra bashkëkohore. Ky është një investim i dobishëm për komunitetin e banorëve të zonës.

Realizimi i projektit për ndërtimin e rrugës "Abdi Bej Toptani" në Valias është bërë i mundur falë buxhetit të Bashkisë, duke qenë se kërkesat për financim projektsh janë refuzuar nga ana e qeverisë aktuale. Pavarësisht nga indiferenca e kësaj qeverie dhe duke pasur parasysh kërkesat e nevojat e mijëra qytetarëve të zonës, në prioritetet e Bashkisë Kamëz ka qenë edhe ndërtimi i kësaj rruge me gjatësi të konsiderueshme dhe që ndikon si në aspektin social ashtu edhe në atë ekonomik.

Kjo, për vetë faktin se realizimi i këtij investimi themelor ndikon jo vetëm në lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe automjeteve, por i jep shtysë edhe zhvillimit të bizneseve, duke qenë një nga rrugët kryesore të Kamzës dhe që bën lidhjen e disa lagjeve të këtij qyteti ndërmjet tyre, por edhe me zonat përreth.

### Vijojnë punimet në rrugën "Pjetër Arbnori" në lagjen 1 Bathore



Vijojnë punimet për ndërtimin e rrugës "Pjetër Arbnori" në lagjen 1 Bathore, një prej 80 projekteve të Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Pas përfundimit të procedurave të prokurimit

dhe lirit të hapësirave, kanë filluar tashmë punimet për ndërtimin e kësaj rruge, që është një nga dhjetëra investimet e reja që Bashkia ka planifikuar për të realizuar në vitin 2018. Ky projekt bëhet i mundur falë buxhetit të Bashkisë, i cili është buxheti më i lartë i miratuar në këtë njësi vendore.

Rruga "Pjetër Arbnori" në lagjen Bathore 1 ka një gjatësi 300 metra linearë dhe me gjerësi 6 ml. Ajo kufizohet nga Bulevardi Blu dhe rruga "Co-Plan", duke bërë lidhjen e mijëra qytetarëve të kësaj lagjeje. Duke qenë se ka dalje në Bulevardin Blu, investimi i Bashkisë në këtë segment rrugor merr një rëndësi të veçantë. Për t'u theksuar është fakti se ky investim së bashku me dhjetëra të tjerë që do të realizohen në Kamëz e Paskuqan, financohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë Kamëz. Ky është edhe destinacioni i të ardhurave që mbledhen nga kjo njësi vendore, e cila jo më kot u rendit edhe Bashkia e parë në shkallë vendi për mirëmenaxhimin financiar.

### Vëmendje maksimale e kryebashkiakut Xhelal Mziu për ndërtimin e një infrastrukture urbane bashkëkohore në gjithë qytetin



Pas lirit të hapësirave për investimin nisin punimet edhe në rrugën "Prengaj" në Fushë-Kërçik. Ky është një tjetër investim i Bashkisë Kamëz që do të realizohet brenda vitit 2018. Vëmendja e kryebashkiakut Xhelal Mziu ka qenë maksimale për ndërtimin e një infrastrukture urbane të plotë, me standarde bashkëkohore, në të gjitha lagjet e qytetit. Kryebashkiaku Mziu ishte i pranishëm në hedhjen e shtresës së fundit të asfaltit në rrugën "Abdi Bej Toptani" në Valias, por së shpejti do të jetë i pranishëm në punimet që po kryhen në dhjetëra investime të Bashkisë Kamëz, siç është edhe rruga "Prengaj" në Fushë-Kërçik. Investimi në rrugën "Prengaj" ka një gjatësi prej 686 metrash linearë, me gjerësi 7 metra, gjerësi asfalti 4.5 metra, me kanalizime të ujërave të bardha dhe me bankina. Këto elemente të përfshira në përbërjen e investimit sjellin një impakt infrastrukturor, si dhe një përmirësim ambientit të menjëhershëm për të gjithë banorët që preken nga investimi. Investimi i rrugës "Prengaj" është financim 100% i buxhetit të Bashkisë Kamëz, e cila vazhdon të ndjekë një politikë të kthimit të taksave dhe tatimeve në pjesën dërmuese të tyre në këtë destinacion. Kryebashkiaku Xhelal Mziu po bën realitet të gjitha premtimet e bëra për ndryshimin e menjëhershëm të gjendjes infrastrukture në gjithë territorin e Bashkisë Kamëz.

### Fillojnë punimet në rrugën "Prizreni", Frutikulturë, një prej projekteve të planifikuara për vitin 2018



Kanë filluar punimet edhe në rrugën "Prizreni", Frutikulturë, një prej projekteve të planifikuara për vitin 2018. Pas përfundimit të procedurave të prokurimit për këtë projekt, ka nisur puna për realizimin e tij. Ndërtimi i rrugës "Prizreni", me gjatësi 700 metra linearë, është një prej 80 projekteve të planifikuara për vitin 2018, që financohet tërësisht me të ardhurat e Bashkisë. Ky investim nuk është i vetmi, si në Frutikulturë ashtu edhe në gjithë territorin e Kamzës, krahas investimeve madhore e të rëndësishme që janë në ndërtim e sipër. Në këtë mënyrë vijon tradita e shkëlqyer e Bashkisë Kamëz për të realizuar investime publike në fusha jetike për banorët, kjo edhe në një kohë kur qeveria nuk ka akorduar asnjë qindarkë për pesë vite me radhë për qytetarët dhe Bashkinë e Kamzës. Janë mbi 130 projekte në dy vitet e fundit, të shpërndara në të gjitha lagjet dhe zonat e Kamzës dhe Paskuqanit, duke iu përgjigjur kërkesave më emergjente të banorëve.

### Investimi në rrugën "Hasan Zylfia" Babrru-Kodër, një tjetër premtim i mbajtur i kryebashkiakut Xhelal Mziu



Pas lirit të hapësirave publike, kanë nisur punimet për ndërtimin e rrugës "Hasan Zylfia" në Babrru-Kodër. Investimi në këtë rrugë është një tjetër projekt i Bashkisë Kamëz dhe një tjetër premtim i mbajtur i kryebashkiakut Xhelal Mziu për banorët e kësaj zone. Duke qenë pjesë e vizionit të kryebashkiakut Mziu për ndërtimin e një infrastrukture bashkëkohore edhe në Paskuqan, ritmet e fillimit të punës janë të larta. Ndërhyrja në këtë segment rrugor kap një gjatësi prej 556 metrash linearë dhe gjerësi 6.5 m, me investime në KUN dhe bankina në të dy krahët e rrugës. Edhe pa asnjë mbështetje financiare nga qeveria e majtë, Bashkia Kamëz vazhdon t'u shërbejë banorëve të Kamzës me të gjitha instrumentet ligjore, duke realizuar një partneritet të shkëlqyer me këtë komunitet. Banorët që jetojnë në këtë lagje, përfutjes në investimin në rrugën "Hasan Zylfia" do ta ndiejnë menjëherë përmirësimin e infrastrukturës dhe për rrjedhojë edhe të përmirësimit të mjedisit që i rrethon.



## Prononcim i kryebashkiakut Xhelal Mziu: Problematikat e arsimit në Kamëz dhe mungesa e vëmendjes nga qeveria

Në një prononcim me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, kryebashkiaku Xhelal Mziu është shprehur se ky vit pritej të ishte ndryshe nga reagimi i qeverisë shqiptare për specifikat që ka qyteti i Kamzës dhe nevojat emergjente për objektet shkollore. Këto nevoja janë të shumta, edhe pse nga ana e Bashkisë dhe e kryetarit Xhelal Mziu janë kërkuar në mënyrë sistematike investime dhe ndërhyrje për rehabilitim të shumë prej objekteve shkollore dhe kopshteve që ndodhen në territorin e Bashkisë Kamëz.

### Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme

Për nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, problem mbetet mosfinancimi i tyre nga qeveria shqiptare. Është kërkuar nga ana e Bashkisë Kamëz ndërtimi i 6 shkollave të reja për të përballuar frekuentimin gjithnjë në rritje të nxënësve. Është kërkuar rikonstruksioni i 6 shkollave të tjera, pasi çdo ditë e më tepër po rrënohen mjediset e tyre. Në disa prej shkollave vazhdon të kryhet mësimi me 2-3 turne, për shkak të mosinvestimit në shkolla të reja. Kemi të bëjmë me ndërhyrje politike në të gjitha nivelet arsimore, në stafin drejtues dhe atë të mësimdhënies. Edhe pse ka shumë tregues realë, të cilët Bashkia i ka të njohur tashmë, ajo mbetet e hapur dhe e gatshme të bashkëpunojë me të gjitha institucionet përgjegjëse për të realizuar qëllimin final, atë të përfitimit të investimeve të duhura në objektet shkollore.



### Për kopshtet

Problemmbetet financimi i objekteve të reja në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz. Mbetet një tjetër çështje e rëndësishme për t'u trajtuar, sepse kemi të bëjmë ende me një realitet të hidhur. Është kërkuar të ndërtohen 6-7 kopshte të reja për të plotësuar nevojat e frekuentimit të këtyre kopshteve të gjithë fëmijëve që jetojnë brenda territorit të Bashkisë. Financimi për rikonstruksionin i 6 kopshteve aktuale në këtë territor. Problem më serioz mbetet ku mbi 50% e fëmijëve në këtë vit të ri shkollor nuk mund të frekuentojnë kopshtet për arsyen e mungesës së objekteve të kopshteve ku për t'u theksuar me forcë është edhe mungesa e thellë e personelit edukativ.

### Shkolla Profesionale

Bashkia Kamëz e gjen me vend të reagojë për një tematikë problemesh që konstatohen në inaugurimin e rikonstruksionit të njërës prej ndërtesave të shkollës.

Ky inaugurim vjen me një njëanshmëri të theksuar të një shkolle të ngritur me kontributin e drejtpërdrejtë të Bashkisë Kamëz në bashkëpunim të ngushtë me donatorë seriozë të institucioneve të huaja dhe me mbështetjen e drejtpërdrejtë të qeverisë "Berisha". Nuk ftohet në këtë inaugurim domosdoshmërisht titullari i kësaj Bashkie, kryebashkiaku Mziu.

Sot kemi aktualisht regjistrime pafund me ndërhyrje të drejtpërdrejta politike të deputetit dhe kryetarit të Partisë Socialiste të zonës. Sot shkolla profesionale nuk e luan plotësisht rolin për të cilin ajo u ndërtua me fondet e donatorëve të huaj si KfW dhe GIS që do të ishte jo vetëm për nxënësit që do të ndiqnin mësimet në këtë shkollë, por edhe për të gjithë ata individë që edhe pse vazhdonin të ushtronin një profesion apo kishin dëshirë të merrnin dije rreth një profesioni ti jepej mundësia e ndjekjes së studimit.

Për të gjitha këto le të jemi të gjithë së bashku një zë i fuqishëm për të ndryshuar këtë realitet të hidhur që politika e qeverisë shqiptare ka për qytetin e Kamzës, për qytetarët e saj ku pavarësisht bindjeve politike, ata mbeten qytetarë të saj dhe kanë nevojë për investime shërbime dhe përkujdesje ndaj tyre.

## Kryebashkiaku Mziu: Pseudoreforma territoriale, konvikti në Kamëz menaxhohet nga Bashkia Tiranë



Reforma territoriale siç nisi keq, ashtu përfundoi, dhe sot rezultoi e pasuksesshme dhe e pazbatueshme në terren. Përveç faktit se bashkitë sot janë të varura financiarisht nga qeveria dhe e ka në dorë ajo sa fonde u jep përmes grandeve, duke i parë me ngjyrimet politike, nuk u financon projektet. Nuk u kanë kaluar as pas 4 vitesh kompetencat e plota bashkive. Një nga bashkitë e cila ka pasur probleme me kompetencat e të cilat ende nuk i kanë kaluar është Bashkia Kamëz.

Kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu, pohon se Kamza "është etalon i diskriminimit nga qeveria "Rama" në moskalimin e kompetencave ose kalimit të tyre i pashoqëruar me faturën financiare, mjetet dhe personelin e duhur". I referohemi edhe një herë tjetër situatës. Kemi p.sh. një konvikt shkollë brenda qytetit të Kamzës, siç është konvikti i shkollës "Loro Boriçi", i Shkollës së Mjeshtërisë Sportive dhe nuk menaxhohet nga Bashkia e Kamzës, por brenda territorit tonë menaxhohet nga Bashkia e

Tiranës. Ky është një problem që kërkon zgjidhje dhe predispozita e kryetarit të Bashkisë Kamëz për t'i dhënë drejtim kësaj çështjeje nuk ka munguar. "Në mënyrë sistematike kemi kërkuar nga Ministria e Arsimit dhe ajo e Financave kalimin e konviktit në vartësinë tonë duke qenë se është pjesë e territorit të Bashkisë Kamëz. Jemi gjendur përballë mungesës së vullnetit të tyre për të na e kaluar këtë kompetencë, mungesës së komunikimit normal institucional", - thotë kryebashkiaku Xhelal Mziu.

Madje, në një prej komunikimeve në përgjigjen e tij, sekretari i Përgjithshëm i MASR, Plarent Ndreca, i kujton Bashkisë Kamëz se të gjitha konviktet e sistemit arsimor parauniversitar u kanë kaluar nën administrim njëseive të qeverisjes vendore. Kryebashkiaku Xhelal Mziu në shkresat dërguar Lindita Nikollës i thekson faktin se duke qenë se konvikti i Shkollës së Mjeshtërisë Sportive "Loro Boriçi" ndodhet në territorin e Bashkisë Kamëz, ndërkohë administrohet nga Bashkia Tiranë, ndaj ne këmbëngulim në faktin që është e papranueshme dhe e paprecedentë që Bashkia Tiranë të administrojë këtë konvikt që ndodhet në territorin e Bashkisë Kamëz.

Bashkëngjitur me shkresën përcjellëse MASR dhe Lindita Nikollës kryebashkiaku Mziu i ka dërguar edhe hartën e planvendosjes së objektit si dhe tabelën 3 "Transferta e pakushtëzuar dhe specifike për bashkitë".

## Regjistrime me ndikim politik në Shkollën Profesionale Kamëz Regjistrime me ndikim politik në Shkollën Profesionale Kamëz



Kryetari i Bashkisë së Kamzës, Xhelal Mziu, ka reaguar ndaj vizitës së ministrit të Financave, Arben Ahmetaj, në Shkollën Profesionale Kamëz, duke dënuar ashpër propagandën e tij, si dhe duke i kujtuar nevojat në arsim dhe mëkatet e kësaj qeverie ndaj banorëve të Kamzës.

Kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu, thotë: "Qeveritarët e sotëm janë të paskrupullt në propagandën e tyre dhe guxojnë ta bëjnë atë edhe aty ku nuk mund të ngjisë fare, por e kanë pafytyrësinë për ta bërë. Dje ministri i Financave, Arben Ahmetaj, ishte si hajn te Shkolla Profesionale Kamëz në kuadër të propagandës "rilindëse", shkollë e cila ndodhet në njësinë administrative më të diskriminuar në vend nga qeveria "Rama", dhe konkretisht nga institucioni

që ai drejton! Kur Bashkia e 6-të më e madhe në vend për nga popullsia ka nevojë konkrete për ndërtimin e 6 shkollave të reja, rikonstruksionin e 9 të tjerave, ndërtimin e 7 kopshteve dhe rikonstruksionin e 6 të tjerave, kreu i Financave me bateritë e propagandës së blerë mburret sikur çfarë ka bërë në Kamëz me një rikonstruksion!

Rikonstruksioni i një shkolle përballë nevojave konkrete nuk është asgjë. Prej vitit 2013 kjo qeveri as e ka vënë ujin në zjarr, pavarësisht kërkesave tona bazuar në projekte konkrete. I kujtojmë z. Ahmetaj që nën qeverisjen e PD-së, në Kamëz u ndërtuan mbi 18 shkolla dhe kopshte! Mëkatet e Ahmetajt dhe qeverisë "Rama" ndaj banorëve të Kamzës janë të shumta. I kujtojmë Ahmetajt se në sirtarët e qeverisë flenë mbi 135 projekte të Bashkisë Kamëz përfshi edhe ato në arsim dhe nga qeveria e "Rilindjes" kemi zero financim. Kjo qeveri i ka hequr Kamzës 6 mijë familje nga skema e ndihmës ekonomike, i është hequr Zyra e Punës, duke kaluar në Tiranë, rast unikal në Shqipëri, duke mos ndodhur në asnjë njësi tjetër vendore".

## Ahmetaj si hajn tek Shkolla Profesionale, kryebashkiaku Mziu i kujton nevojat që ka Kamza në arsim dhe numëron mëkatet e qeverisë ndaj banorëve

Kryetari i Bashkisë së Kamzës, Xhelal Mziu, ka reaguar ndaj vizitës së ministrit të Financave, Arben Ahmetaj, në Shkollën Profesionale Kamëz, duke dënuar ashpër propagandën e tij, si dhe duke i kujtuar nevojat në arsim dhe mëkatet e kësaj qeverie ndaj banorëve të Kamzës.

Kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu, thotë: "Qeveritarët e sotëm janë të paskrupullt në propagandën e tyre dhe guxojnë ta bëjnë atë edhe aty ku nuk mund të ngjisë fare, por e kanë pafytyrësinë për ta bërë. Dje ministri i Financave, Arben Ahmetaj, ishte si hajn te Shkolla Profesionale Kamëz në kuadër të propagandës "rilindëse", shkollë e cila ndodhet

në njësinë administrative më të diskriminuar në vend nga qeveria "Rama", dhe konkretisht nga institucioni që ai drejton! Kur Bashkia e 6-të më e madhe në vend për nga popullsia ka nevojë konkrete për ndërtimin e 6 shkollave të reja, rikonstruksionin e 9 të tjerave, ndërtimin e 7 kopshteve dhe rikonstruksionin e 6 të tjerave, kreu i Financave me bateritë e propagandës së blerë mburret sikur çfarë ka bërë në Kamëz me një rikonstruksion! Rikonstruksioni i një shkolle përballë nevojave konkrete nuk është asgjë.

Prej vitit 2013 kjo qeveri as e ka vënë ujin në zjarr, pavarësisht kërkesave tona bazuar në projekte konkrete. I kujtojmë z.

Ahmetaj që nën qeverisjen e PD-së, në Kamëz u ndërtuan mbi 18 shkolla dhe kopshte!

Mëkatet e Ahmetajt dhe qeverisë "Rama" ndaj banorëve të Kamzës janë të shumta. I kujtojmë Ahmetajt se në sirtarët e qeverisë flenë mbi 135 projekte të Bashkisë Kamëz përfshi edhe ato në arsim dhe nga qeveria e "Rilindjes" kemi zero financim.

Kjo qeveri i ka hequr Kamzës 6 mijë familje nga skema e ndihmës ekonomike, i është hequr Zyra e Punës, duke kaluar në Tiranë, rast unikal në Shqipëri, duke mos ndodhur në asnjë njësi tjetër vendore"



# Bashkia Kamëz, përgatitje e infrastrukturës në të gjitha shkollat dhe kopshtet e qytetit për fillimin e vitit të ri arsimor

Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit dhe Ndërmarrja e Ujësjetës-Kanalizimeve kanë qenë të angazhuara maksimalisht në përgatitjet e infrastrukturës në të gjitha shkollat dhe kopshtet e qytetit me rastin e fillimit të vitit të ri arsimor.

zhvilluar në të gjitha objektet arsimore në territorin e Bashkisë. Pavarësisht se nga ana e qeverisë nuk ka pasur asnjë investim në infrastrukturën arsimore të qytetit të Kamzës dhe Bashkisë nuk i është dhënë asnjë kompetencë apo fonde për të investuar, sërish

Bulçesh.

Bashkia Kamëz ka bërë të gjitha përpjekjet për kushte sa më të mira me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, për sa ka mundësi dhe burime. Pas evidentimit të nevojave dhe problematikave të shkollave dhe kopshteve

**Rikonstruksioni i shkollës “Ibrahim Basha” në Bulçesh, një nga investimet e Bashkisë për vitin e ri shkollor**



Në koordinim të plotë me të gjitha strukturat e tjera të Bashkisë, që janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve, punonjësit e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit dhe të Ndërmarrjes së Ujësjetës-Kanalizimeve kanë kryer të gjitha përgatitjet për të pasur mjedise të pastra, të mirëmbajtura dhe të përshtatshme për nxënësit dhe mësuesit në prag të fillimit të ri shkollor. Kjo punë është

ka qenë Bashkia Kamëz, e cila me strukturat, punonjësit, burimet e të ardhurat e saj ka dhënë kontributin e vet për të ofruar mjedise të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor-edukativ në këtë qytet.

Gjithashtu, pjesë e masave të marra nga Bashkia Kamëz për sa i përket fillimit të vitit të ri shkollor, ka qenë edhe rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Basha” në

ka ardhur edhe ndërhyrja e punonjësve të dy ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimet kryesore për qytetarët e Kamzës, siç është Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit dhe Ndërmarrja e Ujësjetës-Kanalizimeve.

Ndërkaq, nga ana e Bashkisë ritheksohet se qyteti ka nevojë për ndërtimin edhe të disa objekteve arsimore apo për rikonstruksionin e atyre ekzistuese. Por për

të kryer këto investime, fondet janë të papërbalueshme nga Bashkia, ndaj i është kërkuar vazhdimisht qeverisë dhe ministrive të linjës financimi i projekteve që Bashkia i ka të gatshme dhe janë të hartuara sipas standardeve bashkëkohore.

## Kryebashkiaku Xhelal Mziu: Qeveria, zero investim në arsim në Kamëz

Me nisjen e vitit të ri shkollor investimet e qeverisë në sistemin arsimor nuk janë të dukshme, veçanërisht në njësitë administrative që drejtohen nga përfaqësuesit politikë të Partisë Demokratike. Kamza është shembulli i ndëshkimit, diskriminimit të kësaj qeverie, investimet e së cilës në çdo fushë kanë qenë një mollë e ndaluar për komunitetin e kësaj zone, i cili pavarësisht se i ka besuar PD-së, janë të të gjitha bindjeve politike. Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, evidenton qartë mungesën e investimeve në fushën e arsimit në territorin e Bashkisë Kamëz dhe e gjitha kjo nuk ka ndodhur për mungesë të bashkëpunimit të tij si kryebashkiak dhe Bashkisë, por mungesën e vullnetit të qeverisë për të financuar projektet konkrete. “Kemi kërkuar në mënyrë sistematike nga qeveria “Rama” fonde për ndërtimin e kopshteve dhe shkollave të reja. Kërkesat tona kanë rënë në vesh të shurdhër, shkresat dhe projektet e Bashkisë flenë në sirtarët e Ministrisë së Arsimit. Pavarësisht se në Kamëz, veçanërisht nën qeverisjen e Partisë Demokratike janë ndërtuar mbi 18 objekte shkollore (shkolla dhe kopshte) me standarde evropiane, sërish bazuar në numrin e popullsisë, Kamza dhe Paskuqani kanë nevojë për të tjera godina të reja në sistemin arsimor”, - thotë kryebashkiaku Xhelal Mziu.



kryebashkiakut Xhelal Mziu, është e padenjë dhe Kamza do të vazhdojë të ketë të njëjtën vijë sjellje politike ndaj PS-së dhe qeverisjes së saj dhe madje ky diskriminim që i bëhet do t'i shtyjë qytetarët që në zgjedhjet e radhës t'i japin një dërrmim tjetër elektoral asaj force politike dhe qeverisë së saj mashtruese.

Kryetari i Bashkisë Kamëz pohon se zyrtarisht i është

## Kamëz, mungesë personeli në kopshte e shkolla, Lindita Nikolla nuk u përgjigjet kërkesave të kryebashkiakut Xhelal Mziu

Kur viti i ri shkollor erdhi dhe çerdhet, kopshtet dhe shkollat hapën dyert, Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nuk merr asnjë përgjegjësi për t'iu përgjigjur nevojave që kanë këto institucione të edukimit dhe dijës në Kamëz. Shqetësimi është evident dhe për këtë kryebashkiaku i Kamzës, Xhelal Mziu, thotë se ka bërë çmos që në këtë qytet të mos gjendeshim përballë kësaj situate, e cila ka nevojë për zgjidhje sa më të shpejtë dhe kjo kërkon reagim.

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z.Mziu, thotë: “Në Bashkinë Kamëz, e gjashta njësi administrative në vend për nga popullsia, ndër bashkitë e reja e krijuar në vitin 1996, pavarësisht asaj çfarë është bërë deri më tani (veçanërisht nën qeverisjen e PD e

konkretisht në vitet 2007-2013), nevojat janë sërish të mëdha”. Sipas z. Mziu, veç mungesës së ambienteve shtesë si ndërtimi i shkollave, kopshteve dhe çerdheve që janë të nevojshme, sërish edhe për ato institucione aktuale të dijës dhe edukimit mungon personeli i duhur. Pavarësisht kërkesave të Bashkisë Kamëz, Ministria e Arsimit dhe qeveria e “Rilindjes” me Ramën Kryeministër as e ka vënë ujin në zjarr për t'iu përgjigjur kërkesave të kryetarit të Bashkisë Kamëz për shtesë personeli. Në mungesë fondesh nga ana e Bashkisë, nuk janë pak shkresat zyrtare, komunikimi me Ministrinë e Arsimit përmes titullarësh, konkretisht kryebashkiakut Xhelal Mziu dhe ministres Lindita Nikolla, ku z. Mziu pas studimit të bërë dhe verifikimit në terren, i ka

raportuar Ministrisë nevojën për dyfishimin e numrit të edukatoreve, sepse mbi 50% e fëmijëve nuk shkojnë në kopsht për shkak të mungesës së edukatoreve. “Nevoja është konkrete, e konstatueshme në terren dhe emergjente për mungesë sanitare, rojesh si dhe sekretare shkollash. Plotësimi i këtij personeli nga MASR është i detyrueshëm në kuadër të plotësimit të detyrimeve ligjore bazuar në reformën territoriale me VKM “Për transferuat specifike, për financimin e funksioneve të deleguara, ku në vartësi të pushtetit vendor kalon personeli i kopshteve, çerdheve dhe konvikteve”, - thotë z. Mziu.

“Ky diskriminim që ministria dhe qeveria i bën Kamzës është i papranueshëm dhe i patolerueshëm, sepse numri i personelit

është i vogël, ku dua të theksoj që një pjesë e mirë e shkollave dhe kopshteve nuk kanë fare ose kanë mungesë personeli. Te numri i punonjësve ndihmës MASR nuk ka planifikuar fare punonjës mirëmbajtës. Nga studimi, ose më saktë nga konstatimi në terren që kemi bërë si Bashki, theksoj që Kamza ka nevojë për personel shtesë; 95 edukatorë kopshtesh, 19 sanitare, shkollash, 33 roje, 25 mirëmbajtës, pra në total 172 personel shtesë”, - përfundon prononcimin kryebashkiaku i Kamzës, z. Xhelal Mziu.

Por, pavarësisht dhjetëra shkresave në drejtim të MASR, përgjigjja ka qenë negative, duke pohuar se është i mjaftueshëm, sipas tyre, numri ekzistues i personelit. Gjithçka ka rënë në vesh të shurdhër!?”



## Kryebashkiaku Xhelal Mziu: Në gjithë këto vite të qeverisjes së majtë, në Kamëz asnjë investim i vetëm nga qeveria

Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka zhvilluar një takim të zgjeruar pune me drejtuesit kryesorë të administratës së Bashkisë Kamëz.

Në këtë takim, pasi u analizuan të gjithë treguesit e realizuar deri më tani nga ana e drejtorive dhe stafit të tyre, kryebashkiaku Mziu vlerësoi punën e deritanishme nga ana e këtyre drejtuesve.

Pas këtyre z. Mziu theksoi disa nga pikat shumë të rëndësishme që duhen mbajtur gjithmonë në vëmendje për të rritur përqendrimin dhe shërbimin ndaj qytetarëve. “Së pari, duhen respektuar të gjitha marrëdhëniet me qytetarët që kërkojnë të marrin shërbimet në Bashkinë Kamëz. Për këtë duhet të jemi të kujdesshëm, kur ne kryejmë shërbime të cilat në themel të tyre duhet të kenë etikën qytetare pa anashkaluar zbatimin e ligjit.

Së dyti, duhet të përqendrohemi te realizimi i shërbimeve dhe investimeve të planifikuara në respektimin e paketës fiskale, për të cilën koha ka treguar se është një planifikim mjaft objektiv ndaj ofertës qytetare”.

Së treti ai kërkoi nga ana e drejtuesve të jenë kreativë



në zhvillimin e drejtë, duke ruajtur trendin e përvitshëm të qytetit. Ruajtja e trendit të zhvillimit të qytetit sigurisht

kërkon përpjekje të vazhdueshme për të shfrytëzuar të gjitha burimet e duhura financiare që mund të realizojë Bashkia Kamëz, pasi në të gjitha këto vite të qeverisjes së majtë në Kamëz nuk është realizuar asnjë investim i vetëm nga qeverisja e majtë qendrore sikur në Kamëz nuk jetojnë as qytetarë me bindje të majta.

Ky fatalitet që po ndjek politika e qeverisë së Kryeministrit Edi Rama është për të rritur shkallën e varfërimin të qytetarëve të Kamzës, ku mjafton të përmendim faktin që në këta 2-3 muajt e fundit janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 2-3 mijë familje.

“Ky produkt i kësaj qeverisjeje duhet të na mobilizojë jo vetëm si administratë, por të rritet shkalla e marrëdhënies të qytetarëve për t'u sensibilizuar për detyrimet rrjedhëse në përfitimin e investimeve dhe shërbimeve të planifikuara nga Bashkia Kamëz për këtë periudhë dhe vitet në vazhdim”, - tha ndër të tjera kryebashkiaku Mziu.

### Reprezalja “Rama” në 4 muaj/ 25 mijë familje u hoqën nga ndihma ekonomike, 6 mijë në Kamëz!

Kjo qeveri nuk ka të ndaluar ndaj masave represive ndaj qytetarëve shqiptarë, të cilët kërkojnë vëmendjen e saj. Në vend të kulaçit, Rama ka zgjedhur t'u tregojë kërbacën qytetarëve, duke u rritur taksat, duke mos qenë aspak i preokupuar për të kryer reformat e duhura dhe rritur punësimin, duke u rritur tarifat e ujit, energjisë etj. e duke ardhur deri te masa ekstreme, siç është heqja e mijëra familjeve nga skema e ndihmës ekonomike, e thënë ndryshe pamundësi për të pasur as bukën e gojës. Kjo reprezalje ka 7 muaj që ka nisur dhe, siç duket, vazhdon që ky numër të thellohet dhe familjet e hequra padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike të mos rifuten sërish.

Prej nisjes në muajin shkurt të këtij viti, kur nisi aplikimi i sistemit të ri “Rama” të ndihmës ekonomike, u hoqën nga skema mijëra familje, duke ulur me 32 për qind numrin e atyre që përfitonin. Pjesa dërrmuese e këtyre familjeve u ankuan për përjashtim të padrejtë, por ankesat e tyre ranë në vesh të shurdhër. Në fakt, edhe Banka Botërore, e cila është mbështetëse e kësaj

reformë, do të theksonte në rishikimin e fundit të programit në korrik të këtij viti se ndoshta në skemë duhet të shtohen më shumë familje. Edhe opozita e ka denoncuar hapur këtë reprezalje të qeverisë “Rama” ndaj qytetarëve, të cilët janë në kufijtë ekstremë të varfërisë. Një prej bashkive e cila është prekur dukshëm nga ky përjashtim masiv, është dhe Bashkia Kamëz. Kryebashkiaku Xhelal Mziu nga ana e tij ka bërë thirrje për rishikim të situatës, madje duke zbritur në terren dhe verifikuar një për një familjet në nevojë. Edhe sot që flasim, këto familje nuk janë futur në skemë. Që nga fillimi i largimit të familjeve nga skema e ndihmës ekonomike në shkallë kombëtare ka pasur një rënie të konsiderueshme numrit të përfituesve të ndihmës ekonomike. Falë reprezaljes “Rama”, nga 80 mijë familje në dhjetor 2017 në 54 455 në maj 2018, pasi pseudoreforma nisi më 1 shkurt.



### U hoqi kafshatën e bukës shqiptarëve, Rama bën studim për ndihmën ekonomike me paratë e fukarenjve

Kjo qeveri është antiqytetare, shpirtkazmën dhe me atë çfarë po bën, meriton të largohet një orë e më parë. Pasi me të ashtuqajturën reformë të ndihmës ekonomike u hoqi mijëra familjeve shqiptarë në shkallë vendi edhe kafshatën e bukës duke u ndërprerë ndihmën ekonomike bazuar në kriteret qesharake, si për t'u tallur më ta, ka vendosur që me këto para të bëjë studim, për të fryrë xhepat e OJQ-ve apo konsulentëve pranë saj. Kjo është një nismë absurde, për faktin se nuk ke se çfarë studimi t'i bësh një familjeje të varfër, realiteti i së cilës është i prekshëm dhe ajo ka nevojë veçse për vëmendjen e qeverisë. Vetëm në Kamëz qeveria e “Rilindjes” ka hequr nga skema e ndihmës ekonomike 6 mijë familje, duke u mohuar bukën e gojës.

**Lajmi për studimin/** Mirëpo qeveria ka vendosur që të bëjë një studim, i cili ndjek në vetvete efektet që ka pasur reforma e modernizimit të asistencës sociale me fokus ndihmën ekonomike. Përmes fondeve të siguruar nga kredia me Bankën Botërore, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale do të kryejë vlerësimin total të reformës, duke nxjerrë diferencat përmes krahasimit të rasteve specifike (mostrave) që janë sot në skemë si dhe atyre të përjashtuara, pra një vlerësim i situatës para reformës (viti 2014) dhe pas reformës (viti 2018). Kjo analizë do të përfshijë tri rajonet pilote ku nisi zbatimi i reformës, siç është Tirana,



Durrësi dhe Elbasani. “Ky objektiv do të përfshijë zbatimin e analizave apo vëzhgimeve për mostrat e familjeve (që do të mblidhen nga një kompani e pavarur)... Më pas, të dhënat që do të mblidhen, do të analizohen për të përgatitur raportin e vlerësimit të ndikimit”, - thuhet në dokumentet e publikuara nga BB, por që i përkasin Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Objektivi i dytë i kësaj procedure është vlerësimi afatshkurtë i ndikimit të zbatimit në shkallë kombëtare të reformës te

ndihma ekonomike. Studimi do të kryhet nga një konsulent, i cili do të përfshihet në dizajnimin dhe analizën e ndikimeve që ka pasur reforma te familjet, duke kombinuar si situatën reale sot, ashtu edhe atë të pritshme, kur gjithçka të kalojë në bazë të gjerë kombëtare. Konsulenti do të zhvillojë një sondazh të ri, me pyetje të reja, për të siguruar matjen e rezultatit dhe variablave të tjerë të nevojshëm për të verifikuar rezultatin paraprak.

**Nga shkurti qeveria hoqi nga skema 32% të familjeve/** Në shkurt të këtij viti, nisi aplikimi i sistemit të ri të ndihmës ekonomike, që nxori nga skema disa mijëra familje, duke ulur me 32 për qind numrin e atyre që përfitonin. Shumë familje do të ankoheshin se përjashtimi i tyre ishte i padrejtë. Në fakt, edhe Banka Botërore, e cila është mbështetëse e kësaj reforme do të theksonte në rishikimin e fundit të programit në korrik të këtij viti se ndoshta në skemë duhet të shtohen më shumë familje: “Vihet re një progres shumë i limituar i zbatimit të projektit që nga vizita e fundit e mbështetjes së zbatimit në dhjetor 2017. Zbatimi i reformës së ndihmës ekonomike, mbështetur nga projekti, po vazhdon me zgjerimin kombëtar nisur në 1 janar 2018 (edhe pse planifikuar për t'u nisur në shtator 2017). Që nga fillimi i zgjerimit në shkallë kombëtare ka pasur një rënie të numrit të përfituesve të ndihmës ekonomike (që ranë nga 80 mijë familje në dhjetor 2017 në 54 455 në maj 2018) më shumë e lidhur me prapun konservator të vendosur”.




# Performancë financiare efiçente e Bashkisë Kamëz, kryebashkiaku Xhelal Mziu e ka vënë buxhetin në shërbim të qytetarëve

Buxheti i Bashkisë Kamëz është në shërbim të qytetarëve, duke qenë se në 100 lekë të këtij buxheti 50 shkojnë për investime, ndërsa 50 të tjera për rroga dhe shpenzime operative. Sipas specialistëve të financave, në terma të shpenzimeve bashkitë më efiçente në Shqipëri janë Kamza, Kolonja dhe Roskoveci. Xhelal Mziu e ka vënë buxhetin në shërbim të qytetarëve ashtu si Majlinda Bufi në Roskovec dhe kryebashkiaku i Kolonjës.

Në fakt, nuk është hera e parë që vijnë vlerësime të tilla për Bashkinë e Kamzës. Kujtojmë se jo më larg se vitin e kaluar, Ministria e Financave vlerësoi bashkitë në vend në lidhje me menaxhimin financiar, duke u bazuar në 15 kritere që matnin performancën financiare.

Sipas këtij raporti, nga një vlerësim 0-450 pikë, Bashkia e Kamzës mori vlerësimin më të lartë me 440 pikë. Bashkia e Tiranës, më e madhja në vend, u



rendit e teta në radhën e bashkive për sa i përket pikësimit për treguesit e performancës, me 391 pikë.

Kriteret e vlerësimit ishin: Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit; Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor; Numri i urdhër-shpenzimeve të refuzuara nga Thesari; Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar; Urdhër-prokurimet e paautorizuara; Mjedisi i kontrollit; Menaxhimi i Riskut; Aktivitetet e kontrollit; Informimi dhe komunikimi; Monitorimi; Përgatitja e audituesve të brendshëm; Raportimi në kohë i Audituesve; Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm; Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm; Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuar.

Kjo tregon edhe një herë se nuk matet performanca financiare me sa herë del në televizor, por sa e çon buxhetin atje ku duhet. Dhe për këtë Bashkia e Kamzës ka dhënë provat në çdo vit buxhetor, duke qenë se mbi 50 % e tij shkon për investime publike.

## Dështimi i radhës i Edi Ramës - Reforma e financave publike

Një reformë mbi menaxhimin e financave publike që u mor në vitin 2014 e nxitur nga Banka Botërore, duket se ka dështuar në synimet kryesore të saj, sjelljen e borxhit publik në raport me PBB në nivelin 65.5% në vitin 2017 dhe në eliminimin e detyrimeve të prapambetura.

Ministria e Financave publikoi raportin e Monitorimit të vitit 2017 të Menaxhimit të Financave publike 2014-2020 dhe nxori në dukje se drejtimet kryesore për të cilat u ndërmor kjo reformë nuk u realizuan.

Reforma synonte që borxhi publik të arrinte në 65.5% të PBB në fund të 2017-ës, por rezultati ka qenë i ndryshëm, pasi ky raport në buxhetin fakt të 2017 rezultoi në 70.0 % të PBB-së. Raportimi i monitorimit e cilëson këtë objektiv të papërbushur. Gjithashtu raporti i monitorimit zbulon se më 2017 janë akumuluar rreth 2,2 miliardë lekë detyrime të prapambetura, teksa niveli i synuar në strategji ishte 0 lekë detyrime të prapambetura.

Gjithashtu monitorimi i strategjisë ka zbuluar se niveli i investimeve publike ka qenë më pak se parashikimet e bëra në buxhet, duke konsideruar të papërbushur objektivin vjetor për të kryer investime publike në nivelin 4.5% të PBB-së.

Raporti i monitorimit vëren se krahasuar me vlerësimin e kryer në vitin 2011 vërehen përmirësime thelbësore në disa tregues kyç, përfshirë: parashikimin e të ardhurave; menaxhimin dhe raportimin e angazhimeve dhe detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve; gjithëpërfshirjen e paketës së buxhetit dhe informacione të rëndësishme fiskale që tanimë



Indeksi	Indeksi i referencës	Indeksi i referencës (2014)	Indeksi i referencës (2017)	Indeksi i referencës (2017)	Indeksi i referencës (2017)	Indeksi i referencës (2017)	Indeksi i referencës (2017)
1. Buxheti publik në raport me GDP	70.0%	65.5%	70.0%	70.0%	70.0%	70.0%	70.0%
2. Borxhi publik në raport me PBB	65.5%	70.0%	65.5%	65.5%	65.5%	65.5%	65.5%
3. Detyrimet publike në raport me PBB	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
4. Investimet publike në raport me PBB	4.5%	4.5%	4.5%	4.5%	4.5%	4.5%	4.5%
5. Menaxhimi i riskut	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6. Informimi dhe komunikimi	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
7. Monitorimi	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
8. Përgatitja e audituesve të brendshëm	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
9. Raportimi në kohë i audituesve të brendshëm	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
10. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
11. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuar	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

janë të disponueshme për publikun; buxheti i parë i qytetarëve është përgatitur dhe botuar, po ashtu edhe raporti 6-mujor i performancës makroekonomike, fiskale dhe buxhetore të qeverisë si dhe ka përmirësime në aksesin e publikut në informacionin e prokurimit.

Por, raporti ngre shqetësimet në lidhje me: shtrirjen e operacioneve të paraportuara; mungesën e transparencës se transfertave fiskale ndërqeveritare; rregullsinë dhe pjesëmarrjen në buxhetin vjetor; si dhe shqyrtimin legjislativ të raporteve të auditimit të jashtëm. Raporti i monitorimit të

Financave publike përcakton mbështetjen e donatorëve për sektorin e MFP-së, i cili dominohet nga kreditë, rreth 95 për qind të totalit të financimit, të siguruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore (BB).

Donatorë të tjerë në këtë sektor përfshijnë: Bashkimin Evropian (BE), Suedinë, Zvicrën dhe USAID-in, të cilët ofrojnë ndihmën e tyre përmes granteve, mbështetjes buxhetore dhe AT. Gjatë vitit 2017, 20 projekte të mbështetura nga donatorët ishin duke u zbatuar dhe shuma prej 88.17 milionë euro ishin të planifikuara për projekte të reja, po për vitin 2017./monitor/

## Bashkia Kamëz riaplikon në raundin e dytë si lider në projektin BE EU CITIZENS: Building Europe through CIVIC participation

Bashkia Kamëz riaplikon në raundin e dytë si lider në projektin BE EU CITIZENS: Building Europe through CIVIC participation në grantet e Bashkimit Evropian, Programi Evropa për Qytetarët, masa Rrjetëzimi i qyteteve.

Projekti "BE EU CITIZENS: Building Europe through CIVIC participation" ka si qëllim nxitjen e shtetësisë evropiane dhe të pjesëmarrjes qytetare demokratike në nivel vendor. Projekti do të konsistojë në ngritjen e një rrjeti evropian nëpërmjet aktorëve publikë dhe privatë vendorë duke vepruar në inkurajimin e pjesëmarrjes qytetare në proceset e vendimmarrjes ku do të përfshihen disa target-grupe si: qytetarët (ekspertë të fushave të ndryshme, OJF, të rinjtë, gratë); përfaqësues institucionalë (kryetarë, përfaqësues të fushave specifike lidhur me angazhimin demokratik dhe pjesëmarrjen qytetare).

Projekti do t'i kushtojë vëmendje të veçantë një tematike

të rëndësishme, siç është debat për të ardhmen e Evropës dhe sfidat e euroskepticizmit.

Veçanërisht ky projekt parashikon 5 evente evropiane/konferenca, të cilat do të zhvillohen në Kamëz (Shqipëri); Gornja Rijeka (Kroaci); Bar (Mal i Zi); Vjenë (Austri). Ky projekt është i shtrirë në katër shtete të ndryshme, me një periudhë kohore prej 21 muajsh dhe me një numër total pjesëmarrësish prej 898. Ky projekt do të bashkojë qytetarë, bashki, ekspertë, aktorë të shumtë të shoqërisë civile, të rinj, gra, vullnetarë, në favor të angazhimit demokratik në mënyrë që të krijohet një rrjet evropian, me qëllim për të reflektuar mbi qytetarinë evropiane, kuptimin dhe vlerën e saj për të ardhmen e Evropës.

Bashkia Kamëz vazhdon të jetë në listën e bashkive më të mira të Evropës për sa i përket programit "Evropa për Qytetarët". Kështu, më datë 9.7.2018, u shpallën projektet

fituese të programit "Evropa për Qytetarët 2014 - 2020", Masa 2.2: "Networks of Towns", ku Bashkia Kamëz ishte aplikante në këtë thirrje për projektpropozime me projektin "Të jesh qytetar i BE-së: Ndërtimi i Evropës përmes pjesëmarrjes qytetare", me numër aplikimi: N°601784-CITIZ-1-2018-1-AL-CITIZ-NT. Bashkia Kamëz arriti një rezultat të konsiderueshëm të pikëve. Nga 109 aplikime u përzgjedhën 19 prej tyre. Edhe pse Kamza nuk arriti të ishte në listën fituese, në një lloj mënyre është fituese, pasi u rritën kapacitetet dhe u përforcuan aftësitë e hartimit të projektpropozimit dhe rrjedhimisht u arrit një rezultat i kënaqshëm dhe konkurrues me bashkitë evropiane, duke arritur kështu një nivel të lartë përfaqësimi të pushtetit vendor në hapësirën evropiane. Shpresojmë që në thirrjen e ardhshme për projektpropozime, më datë 3 shtator 2018, Kamza të përfaqësojë Shqipërinë në listën e shteteve fituese.



## Kryebashkiaku Mziu, takim me z. Helmfried Dietsch për zbatimin sa më të shpejtë të projektit të ujësjellës-kanalizimeve

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, priti në një takim pune z. Helmfried Dietsch, drejtor në kompaninë "Dahlem", përgjegjëse për zbatimin e projektit të ujësjellës-kanalizimeve. Në takimin me z. Dietsch, kryebashkiaku Mziu ngriti shqetësimin për vonesën e zbatimit të fazave të tjera të projektit të ujësjellës-kanalizimeve, pas përfundimit me sukses të fazës së parë. Ndër të tjera ai theksoi se krahas impaktit pozitiv që sjell ky projekt, ka mbartur me vete edhe disa gjëra negative, që rëndojnë mbi qytetarët e Kamzës. Zgjatja në kohë e projektit ka sjellë një impakt negativ, pasi ka pasur shqetësime të banorëve për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kjo ka çuar edhe në konflikte sociale. Mes të tjerave, z. Mziu tha se ka kërkuar që fazat e projektit të marrin miratimin e Bashkisë, duke qenë institucioni që përfaqëson qytetarët e Kamzës. Gjithashtu, nga ana e tij, z. Mziu kërkoi që projekti të harmonizohet me terrenin dhe të mos mbetet si para 10 vjetësh. Në kuadër të zbatimit sa më të shpejtë të projektit kreu i Bashkisë kërkoi që grupi i ekspertëve të KfW-së dhe kompanive të ketë një bashkëpunim të ngushtë me strukturat e Bashkisë dhe të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, e harmonizuar kjo edhe me terrenin. Projekti duhet të marrë në konsideratë gjendjen aktuale në terren, p.sh. për sa i përket përfshirjes në fazat e tjera të projektit edhe të dy kolektorëve kryesorë, në



të cilët Bashkia ka investuar, për të shmangur përmbytjet nga shirat, pasi nga qeveria nuk akordohet asnjë qindarkë për rehabilitimin e tyre. Në këtë mënyrë Bashkia ka përdorur pjesë të buxhetit të cilat do të shkonin për investime të tjera për qytetin.

Pavarësisht se shprehu një pjesë të problemeve dhe shqetësimeve për sa i përket ecurisë së projektit, z. Mziu theksoi edhe një herë pozitivisht këtë projekt madhor dhe mjaft të dobishëm për qytetin dhe banorët e Kamzës, duke bërë gjithashtu të ditur pritshmëritë e mëdha prej tij.

Po ashtu ai shprehu gatishmërinë e tij,

të Bashkisë Kamëz dhe të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve për të vazhduar në të ardhmen partneritetin e besueshëm të krijuar deri tani, si dhe për të bërë të mundur sa më shpejt zbatimin e projektit.

Nga ana e tij, z. Helmfried Dietsch e falënderoi kryebashkiakun Mziu për panoramën e bërë dhe për shqetësimet e tij. Ai u shpreh se këto shqetësime do t'i bëjë të ditura të strukturat e tjera dhe të partnerët e tjerë të projektit. Z. Dietsch e vlerësoi takimin si të frytshëm, duke qenë se u diskutua në mënyrë të hapur dhe bashkëpunuese. Ndërkaq, ai premtoi se fazat e tjera të

**Kryebashkiaku Mziu: Të angazhuar maksimalisht për bashkëpunim, në mënyrë që fazat e tjera të projektit të zbatohen më shpejt dhe qytetarët e Kamzës të kenë 24 orë furnizim me ujë të pijshëm.**

projektet do të ecin paralelisht, me qëllim që të shkurtrohet koha e përfundimit të projektit, në mënyrë që qytetarët e Kamzës të kenë shërbim të furnizimit me ujë të pijshëm 24 orë në gjithë territorin dhe rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura. Gjithashtu, ai e vlerësoi edhe ftesën e z. Mziu për bashkëpunim sa më të ngushtë mes palëve.

## Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Bashkia Kamëz vazhdon intensivisht punën për verifikimin në terren të abonentëve

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz vazhdon intensivisht punën në terren për verifikimin e të gjithë abonentëve që furnizohen me ujë të pijshëm nga burimet e furnizimit në territorin e Bashkisë Kamëz. Kjo ndërmarrje ka vijuar punën në komunikimin derë më derë në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët për të gjithë gjendjen reale të shlyerjes së detyrimeve në kohë, në mënyrë që t'u bëjë thirrje dhe ndërgjegjësim për rëndësinë e pagesës së ujit.



Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve falënderon qytetarët të cilët janë korrekt dhe që i janë përgjigjur thirrjes së saj. Gjithashtu, kjo ndërmarrje u bën thirrje edhe abonentëve të cilët rezultojnë debitorë ndaj UK Kamëz të paraqiten pranë arkave të ndërmarrjes për likuidim detyrimesh në mënyrë që të mos ketë penalizim për ta. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm është një nga shërbimet kryesore dhe jetike për qytetin e Kamzës, ndaj dhe Bashkia është përqendruar dhe angazhuar që të ofrojë më të mirën për qytetarët e vet. Në kuadër të këtij angazhimi, është duke u zbatuar edhe projekti i ujësjellësit nga KfW-ja, i cili ka hyrë në fazën e dytë të tij, në përfundim të të cilit qytetarët e Kamzës do të kenë furnizim 24 orë me ujë të pijshëm dhe rrjetin e plotë të kanalizimeve me impiantin e përpunimit të tyre.

## Vijon puna e punonjësve të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit për mirëmbajtjen e territorit



Ndër shërbimet e ofruara nga Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit në Bashkinë Kamëz është edhe mirëmbajtja e hapësirave publike të qytetit. Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit ka punuar me përkushtim për sa i përket mbjelljes së pemëve të reja, por edhe mirëmbajtjes së tyre.

Në këtë sektor të punës së ndërmarrjes vihet re progresi që ka pasur nga viti në vit. Ndërkaq, kjo ndërmarrje ka intensifikuar punën për mirëmbajtjen e rrugëve dhe hapësirave të tjera publike në ato zona problematike ku ka nevojë.

Pjesë e kësaj pune të rëndësishme është edhe pastrimi dhe sistemimi në rrugët "Muharrem Bajraktari" dhe "Shebeniku" në Laknas. Ky është një aksion, i cili ka dhënë frytet e tij në të gjitha hapësirat në gjithë territorin e qytetit të Kamzës, jo vetëm në rrugët dhe bulevardet kryesore.

Falë kësaj pune dhe këtij përkushtimi, Kamza ndryshon nga dita në ditë, për sa i përket pastërtisë dhe gjelbërimit e një rol të rëndësishëm ka edhe Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit, e cila krahas drejtorive dhe ndërmarrjeve të tjera jep kontributin e saj për imazhin e qytetit, por edhe të qytetarëve të Kamzës.

## Informatizimi i njësuar, një hap suksesi në rritjen cilësore të shërbimeve

Bashkia Kamëz qëndron e para në shkallë vendi në arritjen e një suksesi të padiskutueshëm në realizimin e informatizimit të plotë të sistemit të shërbimit ndaj qytetarëve. Janë siguruar rreth 99% e të dhënave të hedhura në sistemin elektronik të njësimit të shërbimeve dhe njëkohësisht të kërkesave të qytetarëve të Bashkisë Kamëz.

Kjo punë e shkëlqyer e realizuar tërësisht nga strukturat e Bashkisë bën tashmë të mundur një shërbim në një kohë mjaft të shpejtë për qytetarët. Ky koordinim në mes të institucionit dhe ekspertëve të zbatimit të këtij projekti bëri që në një kohë shumë reale të kemi një ID të njësuar familjare, duke reduktuar në një formë informalitetin. Sistemi GIS tashmë është koherent dhe lehtësisht i zbatueshëm për të dhënë impaktet e tij që ky shërbim të jetë sa më eficient dhe mjaft transparent për të gjithë aktorët e interesuar në kryerjen e shërbimeve në Bashkinë Kamëz.

Kryebashkiaku Mziu, duke vlerësuar punën e deritanishme të strukturave të Bashkisë, ka kërkuar nga ana e tyre që të ndjekin dhe të zbatojnë me përpikmëri pikërisht këtë program në kontekst të shërbimeve ndaj qytetarëve.